



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA” PRISHTINË
Fakulteti i Arteve

Raport i Komisionit të ankesave mbi angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerat dhe ushtrime në Universitetin e Prishtinës " Hasan Prishtina" nr 2/254 të dates 17/07/2024 dhe Thirjes Publike të shpallur me datën 29/05/ 2026 dhe nr. 1/746

Komisioni i ankesave në nivel të Fakultetit i emëruar nga Dekani me date 24.06.2026 në përbërje: 1. Prof. Alberta Troni – Kryetare e komisioni, 2. Prof. Asst. Burim Arifi - Anëtar dhe 3. Prof. Asst. Yllka Fetahaj - Anëtare kanë pranuar katër ankesa të dorëzuara brenda afatit kohor, për të cilat më poshtë komisioni do të paraqet mendimin dhe interpretimin e vet.

Pozita nr. 4 - Një mësimdhënës për lëndët: Solo këndim (BA, O)

Bazuar në ankesën e parashtuar nga kandidatja Ardiana Bytyçi Ismaili me datë 23.06.2026 për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndën Solokëndim, komisioni i ankesave ka rishikuar dokumentacionin dhe konstatuar se kandidatja Ardiana Bytyçi Ismaili ka të përfunduar Doktoraturën në drejtimin profesional “Art muzikor dhe të vallëzim” në fushën shkencore “Shkencat muzikore dhe arti muzikor” në Universitetin e Ri Bullgar, ku sipas Neni 7 të Rregullorës së procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës thuhet se ka përparësi në zgjedhje, mirëpo Doktoratura e saj nuk i përket fushës së ngushtë profesionale të lëndës.

Bazuar në arritjet profesionale, numrin e shumtë të aktiviteteve koncertale në vend dhe në vendet ndërkombëtare, kandidatja Adelina Paloja Morina plotëson kriteret e angazhimit për lëndën në fjalë, në cilësinë e mësimdhënësit. Ajo poashtu ka përvojë pedagogjike duke u zgjedhur Profesor asistent në Universitetin e Pejës “Haxhi Zeka” dhe është PHD kandidat (provimet e përfunduara) në New Bulgarian University.

Komisioni i ankesave qëndron në përputhshmëri të plotë me vlerësimin dhe vendimin e komisionit vlerësues që kandidatja Adelina Paloja Morina të angazhohet për pozitën nr.4 dhe rekomandohet për procedurat e mëtuqjeshme.

Pozita nr. 5 - Një mësimdhënës për lëndët: Histori filmi I –II (BA, O), Histori e filmit (MA, Z)

Bazuar në ankesën e parashtruar nga kandidati Ilirjan Himaj me datë 23.06.2026 pranë Fakultetit për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndën Histori filmi, komisioni i ankesave ka rishikuar dokumentacionin dhe verifikuar që kandidati ka bashkangjitur tërë dokumentacionin sipas thirrjes publike.

Komisioni i ankesave qëndron në përputhshmëri të plotë me vlerësimin dhe vendimin e komisionit vlerësues, ku duke u bazuar në Nenin 7, paragrafi 4 të Rregullorës dhe në bazë të diskrecionit të komisionit vlerësues për dhënien e përparësisë njëzëri kandidatës Ajmon Salihu në mesin e pesë kandidatëve që kanë aplikuar, komisioni i ankesave vendos që ankesa e Ilirjan Himaj të refuzohet dhe kandidatja Ajmon Salihu të propozohet në Këshill të Fakultetit për angazhimin e saj si mësimdhënëse për lëndët e pozitës nr. 5.

Pozita nr. 10 - Një asistent për lëndët: Hyrje në art konceptual dhe media të reja (BA, O), Art konceptual dhe media të reja: Niveli i mesëm (BA, O), Art konceptual dhe media të reja III (BA, O), Art konceptual dhe media të reja IV (BA, O), Studio e pavarur e artit konceptual dhe mediave të reja (MA, O)

Komisioni i ankesave ka pranuar ankesën e kandidatës Nora Murseli të parashtruar në Fakultet me datë 23.06.2026 rreth mos zgjedhjes në pozitën e asistentit për lëndët me pozitën numër rendor 10. Komisioni i ankesave ka rishikuar dokumentacionin dhe ka verifikuar që kandidatja i plotëson kushtet e përcaktuara me thirrjen publike.

Komisioni i ankesave qëndron në përputhshmëri të plotë me vlerësimin dhe vendimin e komisionit vlerësues, ku duke u bazuar në Nenin 7, paragrafi 4 të Rregullorës dhe në bazë të diskrecionit të komisionit vlerësues për dhënien e përparësisë njëzëri kandidatës Leonita Muja në mesin e tri kandidateve që kanë aplikuar, komisioni i ankesave refuzon ankesën e Nora Murselit dhe njëkohësisht shpreh indinjatë për gabimin teknik të mbiemrit të saj në raportin e komisionit

vlërësues. Me këtë rast rekomandohet që kandidatja Leonita Muja të propozohet në Këshill të Fakultetit për angazhimin e saj si asistente për lëndët e pozitës nr. 10.

Pozita nr. 12 - Një asistent për lëndët: Regji filmi III-IV (BA)

Komisioni i ankesave ka pranuar ankesën e kandidatit Granit Dragaj të dorëzuar në Fakultet me datë 23.06.2026 për mos zgjedhjen e tij në pozitën e lartë cekur. Komisioni i ankesave ka verifikuar që kandidati ka të bashkangjitur tërë dokumentacionin e përcaktuar me thirrjen publike.

Komisioni i ankesave qëndron në përputhshmëri të plotë me vlerësimin dhe vendimin e komisionit vlerësues, ku duke u bazuar në Nenin 7, paragrafi 4 të Rregullorës dhe në bazë të diskrecionit të komisionit vlerësues për dhënien e përparësisë njëzëri kandidatës Hana Bucalija në mesin e pesë kandidateve që kanë aplikuar. Komisioni i ankesave refuzon ankesën e Granit Dragës dhe me këtë rast rekomandon që kandidatja Hana Bucalija të propozohet në Këshill të Fakultetit për angazhimin e saj si asistente për lëndët e pozitës nr. 12.


Prishtinë
26.06.2026

Komisioni:

Prof. Alberta Troni – Kryetare e komisionit



Prof. Asst. Burim Arifi – Anëtar



Prof. Asst. Yllka Fetahaj - Anëtare

